



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 5876/8 Prot.

Sarandë, më 04.08.2025

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00

Data e mbajtjes së mbledhjes : 30.07.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: Kryetar i Bashkisë Z.Oltion Çaçi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Gjergji Imeraj
3. Lindita Kondi
4. Denisa Islamaj
5. Festim Mina
6. Ermir Hoxha
7. Dafina Allkushi
8. Katerina Beqo
9. Zana Piro
10. Bejdo Çela
11. Xhino Jaçaj
12. Anjeza Dike
13. Kevin Alikaj
14. Klejdjan Murtaj
15. Përparim Ahmeti
16. Dritan Peçi
17. Indi Rrapaj
18. Pranvera Osmani
19. Shpëtim Ahmeti



- 20. Eugen Qëndro
- 21. Ilva Qëndro
- 22. Vesel Koçiu
- 23. Thanas Gurma
- 24. Elona Mano

Mungojnë :

- 25. Ibrahim Bajrami
- 26. Laureta Çeçi
- 27. Angjele Lapa
- 28. Ilirjan Gërdhuqi
- 29. Farie Hyska
- 30. Enea Vasili

Pranë ambienteve të Sallës së Këshillit Bashkiak u paraqit një grup qytetarësh, të cilët krijuan tensione dhe përdorën gjuhë fyese ndaj këshilltarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në mbledhje. Për të garantuar rendin, sigurinë e këshilltarëve dhe mbarëvajtjen e mbledhjes, u thirr Policia Bashkiake për sigurimin e saj. (Për këtë arsye, bashkëlidhur procesverbalit është administruar edhe materiali video lidhur me situatën e krijuar).

Asaf Stroka : Përshëndetje !

Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë! Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !

Zhvillojmë mbledhjen e Këshillit Bashkiak datë 30.07.2025, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. Informacion mbi situatën e rendit dhe sigurisë publike në territorin e Bashkisë Sarandë nga institucionet ligjzbatuese.
2. **P/vendim** “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Qershor 2025”.
3. **P/vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Qershor 2025”.
4. **P/vendim** “Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.44, datë 30.08.2024”.
5. **P/vendim** “Për miratimin e draft marrëveshjes së partneritetit për projektin zhvillimi i përvojave dixhitale dhe interaktive të tregimit të historive në galerite e artit dhe muzetë”.
6. **P/vendim** “Për miratimin e të ardhurave dhe të taveveve përfundimtare të shpezimeve për programin vendor afatmesëm 2026-2028”.
7. **P/vendim** “ Për një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Sarandë për vitin 2025”.

8. **P/vendim** "Për miratimin në parim të dhënies me qira, me konkurrim, të një sipërfaqeje prej 60 ha, pjesë e pasurisë me nr.8 dhe nr.15 zona kadastrale 2806 për zhvillim aktiviteti prodhim energjie nga burime të rinovueshme, nëpërmjet paneleve fotovoltaike".
9. **P/vendim** " Miratim i korrigjimit të gabimeve materiale".
10. Informacion për situatën e pastrimit në territorin e Bashkisë Sarandë .

Gjergji Imeraj: Propozoj të heqim nga rendi ditës pikën 9, pasi komisioni nuk u mbledh dhe projekti nuk u shqyrtuan.

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës me propozimin e bërë nga zoti Imeraj

Miratohet me 24 vota pro rendi i ditës me propozimin e bërë nga Z.Imeraj.

Asaf Stroka: Viojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

Informacion mbi situatën e rendit dhe sigurisë publike në territorin e Bashkisë Sarandë nga institucionet ligjzbatuese.

I pranishëm përfaqësuesi i Komisarariatit të Policisë Sarandë Z. Gjylani Shehu , i cili prezantoi lexon raportin e përgatitur lidhur me situatën e rendit dhe masat e mara në lidhje me sigurinë publike përgjatë ditëve të sezonit turistik në territorin e Bashkisë Sarandë.

Nga këshilltarët Z. Peçi, Z.Ermir Hoxha, ju drejtuan disa pyetje përfaqësuesit, dhe më tej u zhvilluan diskutime midis këshilltarëve nisur nga situata e rënduar, për shkak të ngjarjeve të zhvilluara ditët e fundit , me të cilat është përballur qyteti jonë.

Asaf Stroka: Viojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Qershor 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 24 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Viojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Qershor 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?





Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 24 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Viojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: **P/vendim** Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.44, datë 30.08.2024”.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 24 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Viojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: **P/vendim** “Për miratimin e draft marrëveshjes së partneritetit për projektin zhvillimi i përvojave dixhitale dhe interaktive të tregimit të historive në galerite e artit dhe muzetë”.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, ka ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Fjalën e merr Z. Hoxha , në cilësinë e kryetarit të komisionit të arsimit, rinisë , sporteve , i cili u shpreh se Projektvendimi u morrë në shqyrtim dhe në praninë e përfaqësueses së sektorit të projeteve Zj.Vjeri nga e cila u dha një shpjegim analitik lidhur me këtë projekt për të cilin do të zhvillohet mbi bazën e kësaj marrëveshje,I cili ka qënë ezaures dhe mendojmë se është dicka shume e mirë që pritet të ndodh lidhur me jetën kuturore të qytetit. Duke nisur nga galleria e arteve e scila do te pajiset me aspektin dixhital i cili është dicka qe i mungon asaj.

Pyetje dhe komente të tjera nuk ka.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin .

Miratohet me 24 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Viojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: **P/vendim** “Për miratimin e të ardhurave dhe të tavanëve përfundimtare të shpezimeve për programin vendor afatmesëm 2026-2028”.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

REPUBLIKA E
BAJKIA SARANDE
SEKRETI
BASHKIA SARANDE

Miratohet me 24 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Viojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës: **P/vendim** “ Për një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Sarandë për vitin 2025”.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 7 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga këshilltarët?

Fjalën e merr Z. Imeraj, I cili u shpreh se projekt vendimi u morrë në shqyrtim në komisione dhe është plotësuar dhe detajuar me gjithë informacionin dhe dokumentacionin , dhe vlerësojmë se duhet te miratohet me qëllim arritjen e objektivave lidhur me investimet e Bashksië.

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 24 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Viojmë me pikën e tetë të rendit të ditës: **P/vendim** “Për miratimin në parim të dhënies me qira, me konkurrim, të një sipërfaqeje prej 60 ha,pjesë e pasurisë me nr.8 dhe nr.15 zona kadastrale 2806 për zhvillim aktiviteti prodhim energjie nga burime të rinovueshme, nëpërmjet paneleve fotovoltaike”.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 8 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Z.Shpëtim Ahmeti, Do ju kërkoja duke qënë se kjo është një çështje e nxehtë dhe meqënëse kanë ardhë qytetarë jashtë sallës , kërkoj që të vijë një përfaqësues i tyre,

Z. Gjergj Imeraj, Janë zhvilluar dëgjjesat publike lidhur me këtë projekt vendim,

Z. Shpëtim Ahmeti , Janë zhvilluar herën e parë,

Z.Asaf Stroka , Në cilësinë e Kryetarit te Këshillit për të sqaruar procedurën ,ju informoj se pranë Sekretarisë së Këshillit nuk është paraqitur asnjë kërkesë nga palët e interesuar për të marrë pjesë dhe për të folur në mbledhjen e këshillit , dhe për të sqaruar dhe këshilltarët dhe publikun , lidhur me këtë projekt vendim, janë zhvilluar dy degjësra të njëpasnjëshme dhe komuniteti në fjalë kanë qënë prezent,kanë qënë ekspertet , të cilët janë degjuar dhe kanë bërë pyetjet e tyre, nga ana tjetër ju informojë se nga ana e Këshillit do tui vendoset në dispozicion cdo lloj akti që do të kërkohet nga ana e tyre.

Z.Dritan Peçi , Doja të pyesja nga Drejtoria Juridike , meqënëse kjo situatë ka ngjallë interes nga disa banorë, une personalisht dhe disa këshilltarë të tjerë kemi verifikuar dhe pronar është Bashkia Sarandë dhe dokumentacioni është i plotë dhe i saktë lidhur me projektvendimin që ne sot diskutojmë në rend dite, do të doja të dija nëse në një të ardhme e përfitojnë këtë pronë dhe gjykata ose kushdo ku ata i janë drejtuar i jep të drejtën me një certifikatë pronësie ka të drejtë ta prish këtë kontratë , sepse ne me qira e japim dhe pasi ne sot e japim këtë sipërfaqe si kullote me 300 lekët dhe sot do ta japim për nje aktivitet tjetër, a mund të prihet kontrata?

Znj. Garufo Koka, Lidhur me projekt vendimin, sic e kemi diskutuar dhe gjatë dëgjësave të zhvilluara në kuadër të këtij projekt vendimi, komisionet e këshillit bashkiak, ne ju kemi prezantuar të gjithë kuadrin ligjor rregullues lidhur me këtë projekt vendim. Une dua ta ndaj në dy momente, përgjigjen për pyetjen tuaj. Lidhur me projekt vendimin, ne ushtrojmë me atë të tij tagrin e pronësisë, pasi jemi pronar dhe si cdo subjekt tjetër i së drejtës civile, ne kemi te drejten dhe detyrimin për të shfrytëzuar asetet tona me qëllim për të sjellë përfitime në buxhetin e Bashkisë. Për sa i përket pretendimit të banorëve, pretendimi i tyre gëzon sigurinë juridike të rregulluar nga legjislacioni shqiptar, dhe në këtë rast janë organe të treta që do ta shqyrtojnë atë dhe lidhur me kontratën, po ashtu gëzon sigurinë në parashikimet e kontratës së qirasë në kodin civil ku janë të rregulluara rastet e ndryshimit të pronësisë dhe ku pasojat që vijnë prej saj. Në këtë rast objekti i projekt vendimit është dhënie me qira, dhe asnjë lloj tjetërsimi të kësaj prone.

Z. Shpëtim Ahmeti, Do të doja të përsërisja edhe njëherë kërkesën

Z. Asaf Stroka, Po ju sqarojë edhe njëherë, se për projekt vendimin janë zhvilluar dy degjesa,

Z. Shpëtim Ahmeti, Po ashtu është, por të vi dikush që te flasi prej tyre,

Z. Asaf Stroka, Nisur nga situata dhe tensioni i krijuar, nisur nga sjellja e këtyre qytetarëve për të siguruar mbarëvajtjen dhe sigurinë e mbledhjes, po zhvillojmë mbledhjen pa praninë e tyre.

Z. Gjergji Imeraj, Për të sqaruar edhe njëherë, për të kuptuar edhe banorët, qytetarët nuk i mohoet e drejta, neve me anë të këtij projekt vendimi japim një dakortësi që kjo sipërfaqe të jepet me qira, të zhvillohet, pasi është zhvilluar degjasat publike, dhe pasi ka rënë dhe masa e sigurimit, pra Bashkia sot e ka në pronësi, sdo të thotë që humbasin të drejtën pretenduesit, pra nuk mund të të zhvillojë pronën një që e pretendon pronën dhe jo ai që e ka me certifikate pronësie. Pra ne te gjithë bashke përgjigjemi për pronat që kemi në pronësi.

Z. Përparim Ahmeti, shohim që materiali nga pas projekt vendimi është plote për të na dhene te drejten për ta dhene me qera, une doja të pyesja lidhur me të ardhurat që priten të vijnë nga kjo.

Znj. Garufo Koka, Ne relacionin bashkelidhur projekt vendimit është dhe gjithë shpjegimi lidhur dhe me të ardhurat që priten të vilen nga kjo, kemi një referencë ligjore lidhur me cmimin e qirase në bazë të një VKM-je përkatëse dhe niveli pritet të jetë 1056.000 e cila është vlera maksimale që mund të merren nga aktivitetet që mund të zhvillohen në këto sipërfaqe kullimore.

Z. Asaf Stroka, pyetje të tjera, diskutime

Z. Shpëtim Ahmeti, Referuar relacionin përkatës, ne si opozitë, dhe konkretisht Partia Demokratike e ka pasur strategji që Shqipërinë ta bëjë superfuqi të energjisë, edhe të rinovueshme, dhe ato që kishte ju jeni të vonuar dhe i sillni këto projekt vendime tani, dhe nuk dua të paragjykojë, ne do të gjykojmë so do gjykojnë dhe kolegët e tjerë.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 24 vota pro, abstënim 0, kundër 0.

REPUBLICA E SHKIA SARANDE

Për këtë pikë të rendit të ditës, pranë Sekretarisë së Këshillit Bashkiak është depozituar shkresa e këshilltarit, i cili paraqet pretendimet e tij lidhur me procesin e votimit, si më poshtë:

“Unë Shpëtim Ahmeti në cilesinë e këshilltarit në këshillin bashkiak dëshiroj të bej me dije se, gjatë shqyrtimit dhe votimit të pikes 8 rendit ditës, për shkak të kundershive të mia kam zgjedhur të abstenoj nga votimi.

Ky qëndrim është marrë me bindje të plotë dhe në respekt të përgjegjësisë time për të përfaqësuar interesin publik dhe transparencën instucionale.

Ju lutem kjo deklaratë të meret për dijëni dhe përfshihet në proces verbalin përkates si pjesë e qëndrimit tim zyrtar.”

Asaf Stroka: Viojtmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës.

Informacion për situatën e pastrimit në territorin e Bashkisë Sarandë .

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 10 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Z. Shpëtim Ahmeti, Dje me Drejtorin e Shërbimeve në komisionin e shërbimeve, ja kam shprehur vleresimin për punët e mira por duhet marrë masa për blloqet e banime. Duhet marrë masa për pastrimin, disifektimin pasi vende vende nuk ka vend për depozitimin e embetjeve. Ka disa mangësi për kosha mbeturinash.

Z.Jolio Dine, Jam i njohur me shqetësimin e zonës së përmendur nga ana juaj Lagja nr. 1 (Lagja amerikane) lidhur me mungesën e koshave , dhe pas komunikimit me firmën e pastrimit dhe problemi në atë zonë është lidhur me ngushtesinë e rrugëve dhe shpesh bllokimi i automjetit të pastrimit për të hyrë ose dale nga zona, shpresoj që të gjejme shume shpejt zgjidhjen me qëllim arrijtjen e aksesimit edhe gjatë fluksit dhe gjatë dimrit që firma e pastrimit të pastrojë konteneret në atë zonë. Shpresojme në muajin Shator të gjejme zgjidhjen përfundimtar.

Z.Bejdo Çela, Jam njohur me informacionin dhe e vleresojë mjaft pozitiv , por doja të dija lidhur me larjen e kryer, dhe do ishte me mirë që të kishim dhe një kopje të kontratës, për tregu industrial u la vetëm njëherë.

Z. Jolio Dine, Lidhur me kontratën, është një informacion i cili nuk është kërkuar nga ana e këshilltarëve për tu vendosur në dispozicion, nuk mund ta mohoj se ka problematika të ndryshme por ashtu sic cdo qytetarë, këshilltarë të bashkëpunojmë me ne lidhur me këto problematika , pastrimi është përpjesi e Kryetarit të Bashkisë, dhe ne ne cdo rast që kemi patur gjëra që janë bërë evidente jemi mundur për të vepruar në kohë.

Z.Përparim Ahmeti, Lidhur me Ksamilin, është për të përgjatur situata , krahas problematikave që janë neper lagje dhe mbase duhet shtuar vëmendja , por duhet shtuar ndergjegjësimi qytetarit për ruajtjen e pastrisë. Vioj punën sic e ke nisur.

Z.Vesel Koçiu, Përtej problematikave të sjella në vëmendje nga koleget , duhet të jemi kritik ndaj shërbimeve , pasi pastrimi është një ceshtëje e ndjeshme për të gjithë qytetarët. Rruget e



qyteteve nuk lahet dhe nuk kerkohet llogari si eshte grafiku I larjes se qytetit , troturet jane te mbushur me pluhur , edhe rruget kryesore duhen pare me kujdes . Duhet pare me vemendje reziimi I sherbimeve nga sipas grafikut te punes.

Z.Jolio Dine, lidhur me shërbimin e larjes se rrugeve në Sarande dhe Ksamil, une si Drejtues i Drejtorise se Sherbimeve Publike, jam në komunikim të vazhdueshme në çdo orë me firmen e pastrimit dhe me gjithe grupin që merret me sektorin e pastrimit brenda drejtorise , dhe ju garantoj se larja e bulevardit është e përnatshme e përditshme , dhe kam prova faktike që kryhet, nuk bëhet gjatë orarit te ditës , por gjatë orëve të natës. Ajo që është shqetesim në gjykimin tim është bashkëpunimi i qytetarëve.

U zhvilluan diskutime lidhur me fokusin e sensibilizimin që duhet kryer, për bizneset e qytetarve lidhur me oraret e heqjes se mbetjeve.

Z.Asaf Stroka : Duke ju falenderuar , e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr.rendor 8 (tetë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i procesverbalit: Valbona Vasili



Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

- | | | |
|-----|--------------------------------------|-----------------|
| 1. | Kryetar i Këshillit Bashkiak : | Asaf Stroka |
| 2. | Zëvendëskryetar i Këshillit : | Lindita Kondi |
| 3. | Zëvendëskryetar i Këshillit : | Klejdjan Murtaç |
| 4. | Zëvendëskryetar i Këshillit : | Bejdo Çela |
| 5. | Partia Republikane Shqiptare : | Përparim Ahmeti |
| 6. | Fryma e Re Demokratike: | Ilir Gërdhuqi |
| 7. | Kryetar i Grupit Bashkë Fitojmë: | Shpëtim Ahmeti |
| 8. | Kryetar i Grupit Partia Demokratike: | Vesel Koçiu |
| 9. | Aleanca Arbnore Kombëtare: | Xhino Jaçaj |
| 10. | Partia Lëvizja e Legalitetit: | Kevin Alikaj |

